

URDHËR
Nr. 93, datë 30.3.2018
PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM
TË KOMPETENCAVE

Në zbatim të nenit 28 dhe nenit 29, të Kodit të Procedurave Administrative, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, të nenit 26 të rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, të ndryshuar me urdhrin nr. 150, datë 26.9.2017,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit në funksion të kontrollit të figurës së subjekteve të rivlerësimit, përgjegjës të grupit të punës, z. Adhurim Hasanaj.
2. Z. Adhurim Hasanaj i delegohen kompetencat si më poshtë:
 - a) Mbikëqyr dhe udhëzon grupin e punës për kontrollin e figurës së subjekteve të rivlerësimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.
 - b) Përfaqëson grupin e punës në marrëdhëniet me:
 - Komisionin e Pavarur të Kualifikimit;
 - Kolegjin e Apelimit dhe Komisionerët Publikë;
 - Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM);
 - c) Organizon dhe drejton veprimtarinë e grupit të punës;
 - ç) Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimit, objektit dhe detyrave për të cilat është ngritur grupi i punës.
3. Ky urdhër do të jetë në fuqi për periudhën 2.4.2018 deri më 6.4.2018.
4. Z. Hasanaj nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca.
5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Hasanaj, përgjegjës i grupit të punës; Drejtoria e Vettingut dhe Sigurimit Industrial; Drejtoria e Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrisë Qendror; Sektori i Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit; Drejtoria e Financës, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTORI
Dorian Tola